

VENDIM
Nr. 929, datë 29.12.2014

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 561, DATË 12.8.2005, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE REFERUESE PËR LLOGARITJEN E
PENSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Paga referuese, për periudhën e sigurimit të ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, para datës 1.1.1994, të jetë 1 619 (një mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë në muaj.”.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama